

AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE



RAPORTI VJETOR

2022

Rruga "Asim Vokshi", nr.19/1,
Tiranë-Shqipëri

<https://amp.gov.al>

Të nderuar lexues

Ndërsa lëmë pas një vit të ngarkuar me sfida dhe projekte mjaft të rëndësishme për rritjen e standardeve të Agjencisë, është kënaqësia ime që t'ju prezantoj Raportin Vjetor të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për vitin 2022. Agjencia është përpjekur përgjatë gjithë vitit 2022 të përmbushë me sukses detyrimet e saj në zbatim dhe respekt të ligjit e pritshmërive të publikut për një institucion me integritet të lartë dhe profesionalizëm, në funksion të misionit të saj për mbikëqyrjen e vazhdueshme, të pavarur, objektive dhe transparente të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Jam i lumtur që nën drejtimin e Ministrisë së Brendshme dhe në bashkëpunim me partnerët tanë e aktorë të tjerë të rëndësishëm, kemi vijuar punën për konsolidimin e Agjencisë, duke e përafëruar atë me standardet e organizatës së Partnerëve European Kundër Korrupsionit (EPAC), apo homologëve tanë europianë. Rritja dhe forcimi i rolit mbikëqyrës të Agjencisë kundër paligjshmërive ndër radhët e strukturave (me fokus të veçantë korrupsionin dhe abuzimin me detyrën), si edhe përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve kanë qenë në fokus të punës për përmbushjen e detyrimeve tona ndaj qytetarëve, ndërsa ka vijuar në mënyrë të pandërprerë puna për rikonceptimin e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2022 janë miratuar një sërë aktesh nënligjore nga Këshilli i Ministrave, Ministrat të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, në funksion të implementimit të Ligjit nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, si dhe me qëllim konsolidimin e saj në aspektin organizativ, funksional dhe strukturor, duke reflektuar gjithashtu prioritetet dhe objektivat e parashikuara në dokumentet strategjike afatmesme si; “Strategjia për Zhvillimin e Agjencisë 2020 – 2024”, “Plani i Veprimtimit 2020 – 2022”, “Programi Vjetor i AMP-së 2022” si dhe Programi i 300 - ditëve të Ministrisë së Brendshme.

Strukturat e Agjencisë në qendër dhe rajone kanë përmbushur me sukses detyrimet e tyre në aspektin e hetimit të veprimtarive të kundërligjshme, inspektimeve dhe trajtimit të ankesave të qytetarëve për punonjësit e strukturave objekt i veprimtarisë së AMP. Gjatë vitit 2022 janë administruar **1970 ankesa** dhe dërguar pranë organit të ndjekjes penale **245 referime penale**, të cilat janë regjistruar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes/Moduli i Hetimit të Ankesave&Moduli i Hetimit Procedural Penale. Janë kryer gjithsej **117 inspektime**, në përfundim të të cilave janë dhënë **152 rekomandime**, si dhe është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor ndaj **150 punonjësve të strukturave**, gjë që tregon edhe më tej një rritje cilësore të profesionalizmit dhe integritetit të strukturave të hetimit. Nga ana tjetër, Komisioni Disiplinor i Agjencisë ka trajtuar gjithsej **35 praktika**, nga të cilat për 8 praktika është vendosur për dhënien e masave disiplinore “Përfundim nga Policia”, “Shtyrje e afatit të gradimit për 2 vite” dhe “Shtyrje e afatit të gradimit për 6 muaj” për 12 punonjës policie të niveleve të ndryshme.

Gjithashtu, dixhitalizimi dhe rritja e kapaciteteve të Agjencisë nëpërmjet aplikimit të teknologjive bashkëkohore të informacionit ka qenë në fokus të Agjencisë, për të cilën me fonde buxhetore dhe në bashkëpunim edhe me partnerët tanë më të ngushtë (si ICITAP) janë realizuar projekte për sigurimin dhe vënien në efikasitet të “Sistemeve të reja analitike të informacionit iBase & i2 Analyst Notebook”, si edhe “Sistemit të Menaxhimit të Çështjes Moduli i Ankesave/ Moduli i Hetimit Procedural Penal”. Këto sisteme i shërbejnë rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të proceseve informativ - gjurmuese, analizës së informacionit kriminal, hetimit administrativ dhe atij procedural penal që kryhet nga strukturat e Agjencisë.

Duke ju uruar lexim të këndshëm, falënderoj strukturat e AMP, Ministrinë e Brendshme dhe partnerët tanë, të cilët n'a kanë mbështetur dhe udhëhequr në të gjitha përpjekjet tona për forcimin e mëtejshëm të Agjencisë, duke çelur sëbashku një fazë të re të mbikëqyrjes policore, për një institucion më civil dhe bashkëkohor në shërbim të qytetarëve.

I. HYRJE.....	3.
II. ARRITJET KRYESORE DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS SË AGJENCISË PËR VITIN 2022.....	4.
II.1. Vijimi i konsolidimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.....	4.
II.2. Dixhitalizimi dhe informatizimi.....	5.
II.3. Hetimi disiplinor i subjekteve mbikëqyrëse të Agjencisë.....	5.
II.4. Mbikëqyrja nëpërmjet hetimit administrativ të Ankesave e Inspektimeve.....	6.
II.5. Mbikëqyrja nëpërmjet veprimtarisë së hetimit procedural penal.....	10.
II.6. Mbikëqyrja nëpërmjet CSP.....	14.
II.7. Integriteti/Vetingu i punonjësve të Agjencisë dhe të strukturave mbikëqyrëse.....	15.
II.8. Menaxhimi i shërbimeve mbështetëse.....	16.
II.9. Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë/trajnimi i vazhdueshëm i personelit.....	17.
II.10. Bashkëpunimi ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit.....	18.
II.11. Proceset integruese të Shqipërisë në BE/përmbushja e detyrimeve nga Strategjitë Ndërinstitucionale dhe Planet Konkrete të Veprimit.....	18.
III. SFIDAT/PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023.....	19.



I. HYRJE

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është një institucion i mbikëqyrjes së jashtme policore me kompetenca, si parandaluese, ashtu edhe represive ndaj çdo sjellje jo etike, abuzimit me detyrën, shkeljes së ligjit dhe paligjshmërisë në përmbushje të detyrës funksionale dhe të performancës së strukturave, objekt i veprimtarisë së saj.

Në funksion të reformimit të vazhdueshëm institucional dhe përshtatshmërisë ligjore, organizative e funksionale me detyrimet ligjore të përcaktuara nga reforma në sistemin e drejtësisë; ngritjes së institucioneve të reja, procesit të vetingut në Polici e jo vetëm, Agjencia ka ndërmarrë një sërë reformash afatgjata dhe afatmesme në interes të përmbushjes së standardeve të kërkuara.

Në këtë kontekst, si dhe në analizë të realizimit dhe përmbushjes së prioriteteve dhe objektivave të parashikuara në Dokumentin Strategjik Afatmesëm “*Strategjia për Zhvillimin e Agjencisë 2020 – 2024 dhe Planit i Veprimit 2020 – 2022*”, sikurse edhe në linjë me Vizionin 2030 të qeverisë shqiptare dhe të Planit 300 – ditor të Ministrisë së Brendshme, viti 2022 ishte përcaktuar si viti i konsolidimit të Agjencisë së re të Mbikëqyrjes Policore, në aspektin organizativ, funksional dhe strukturor. Prioritetet dhe objektivat kryesore për vitin 2022, të përcaktuara në Programin Vjetor të Agjencisë, miratuar nga Ministri i Brendshëm, kanë qenë:

Prioriteti I

- Vijimi i konsolidimit organizativ dhe funksional i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Prioriteti II

- Përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve.

Prioriteti III

- Rritja dhe forcimi i rolit mbikëqyrës të Agjencisë kundër paligjshmërive ndër radhët e strukturave, me fokus të veçantë korrupsionin dhe abuzimin me detyrën.

Prioriteti IV

- Rikonceptimi i procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit.

II. ARRITJET KRYESORE DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS SË AGJENCISË PËR VITIN 2022

II.1. Vijimi i konsolidimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore

Pas miratimit të Ligjit nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore” dhe hyrjes në fuqi, me aktin administrativ të Drejtorit të Përgjithshëm u ngrit Grupi Qendror i Punës dhe 11 Grupe Teknike të Punës për draftimin e paketës së akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Përgjatë vitit janë hartuar në konsultim me ministrinë e linjës dhe aktorë të tjerë, si dhe janë miratuar aktet nënligjore **1 Urdhër** i Kryeministrit “Për Strukturën e Agjencisë”, **2 Vendime** të Këshillit të Ministrave “Për Pagat dhe Rregulloren e Organizimit e Funksionimit të Agjencisë” dhe **1 Udhëzim** i Ministrit të Brendshëm “Për procesin informative, në funksion të veprimtarisë parandaluese të Agjencisë”.

Në funksion të një prej përgjegjëseve ligjore të shtuara të Agjencisë, atë të Hetimit Disiplinor për “Shkelje të rënda” të subjekteve, objekt i veprimtarisë së saj, janë miratuar **3 Urdhra** të Drejtorit të Përgjithshëm, të cilat rregullojnë dhe normojnë procesin e hetimit disiplinor dhe strukturën përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e tyre.

Në aspektin organizativ, është vazhduar gjatë vitit 2022 me të njëjtën strukturë organizative në nivel vendor dhe qendror, deri në momentin e miratimit të Urdhrit të Kryeministrit “Për miratimin e Strukturës dhe Përbërjes së Re të Agjencisë” dhe më pas janë mundësuar hapat e mëtejshëm për implementimin e saj, duke u riorganizuar në funksion të përgjegjëseve dhe kompetencave të reja ligjore dhe institucionale. Përgjatë vitit 2022 janë riemëruar 39 punonjës të Agjencisë në detyrat e tyre aktuale por edhe me motivacionin “për ngritje në detyrë”. Gjithashtu është kryer procesi i shpalljes së vendeve vakante në Agjenci, konkretisht:

➤ Shpallja e vendeve vakante dhe zhvillimi i procedurave konkurruese për rekrutimin e personelit të ri, ku për **24** vendet vakante të shpallura:

- **83** aplikantë, nga të cilët:
 - **49** aplikantë të skualifikuar dhe
 - **34** aplikantë të kualifikuar

Pas testimit me shkrim, nga **34** aplikantë kanë kaluar në fazën e intervistës **31** aplikantë.

- Fazat e tjera të konkurrimit do të zhvillohen gjatë vitit 2023.
- Ka filluar procesi i hartimit dhe miratimit të Procedurave Standarde të Punës dhe Përshkrimeve të Punës për çdo veprimtari dhe funksion në strukturat e Agjencisë në të dyja nivelet (vendor e qendror).

Në aspektin funksional është bërë përpjekje maksimale nga të gjitha strukturat e Agjencisë për përmbushjen e objektit të veprimtarisë, prioritetëve dhe objektivave të parashikuara në dokumentet strategjike afatmesme si; “Strategjia për Zhvillimin e Agjencisë 2020 – 2024”, “Plani i Veprimit 2020 – 2022”, “Programi Vjetor i AMP-së 2022” si dhe Programi i 300 - ditëve të Ministrisë së Brendshme.

II.2. Dixhitalizimi dhe informatizimi

Dixhitalizimi/rritja e kapaciteteve të Agjencisë nëpërmjet aplikimit të teknologjive bashkëkohore të informacionit – aktualisht me fondet buxhetore dhe donacionet nga partnerët tanë më të ngushtë (si ICITAP) janë realizuar projekte për sigurimin dhe vënien në efikasitet të:

- “Sistemeve të reja analitike të informacionit iBase & i2 Analyst Notebook”,
- “Sistemit të Menaxhimit të Çështjes Moduli i Ankesave/ Moduli i Hetimit Procedural Penal”.

Këto sisteme i shërbejnë rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të proceseve informative, analizës së informacionit, hetimit administrativ dhe atij procedural penal që kryhet nga strukturat e Agjencisë. Gjithashtu, ato i shërbejnë rritjes së mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë dhe llogaridhënies sipas linjës epror – vartës, për përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi funksionale të gjithsecilit.

Gjatë vitit 2022 është punuar në konfigurimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit iBase (SMI Ibase) sipas kërkesave dhe në përshtatje me mënyrën e organizimit strukturor të Agjencisë, si dhe përcaktimeve në aktet nënligjore që normojnë veprimtarinë informative – gjurmuese.

Një theks i veçantë i është dhënë edhe sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të Agjencisë. Kjo, nisur nga njëra anë prej sulmit kibernetik që pësoi rrjeti i institucioneve kryesore shqiptare (AKSHI) dhe nga ana tjetër, nga natyra e veprimtarisë sensitive dhe konfidenciale që performojnë strukturat e Agjencisë në përmbushjen e objektit të veprimtarisë së saj.

Kështu, nëpërmjet prokurimit të klasifikuar me objekt “Blerje pajisje për arkivën dixhitale, ndarjen e saj më vete dhe instalim, konfigurim dhe implementim brenda rrjetit të Agjencisë”, u mundësua plotësimi sipas kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këto procedura për rrjetet që qarkullojnë informacion të klasifikuar.

II.3. Hetimi disiplinor i subjekteve mbikëqyrëse të Agjencisë

Ligji nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore” i ka atribuuar Agjencisë përgjegjësi ligjore dhe funksionale të shtuar, e cila është “Hetimi Disiplinor për shkelje të rënda të punonjësve të strukturave mbikëqyrëse”. Përgjegjësi kjo, e cila nëpërmjet akteve nënligjore “Rregullorja e Organizimit dhe Funksionit të Agjencisë” miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe akteve normative të Drejtorit të Përgjithshëm, ka filluar të implementohet dhe zbatohet gjatë 4-mujorit të fundit të vitit 2022. Kështu, nga Komisioni Disiplinor i Agjencisë, mbi bazën e sugjerimeve/rekomandimeve të ardhura nga strukturat vendore dhe qendrore të Agjencisë, të cilat gjatë veprimtarive të hetimit administrativ të ankesave e inspektimeve dhe hetimit procedural penal, kanë konstatuar shkelje të karakterit administrativ nga punonjës të strukturave mbikëqyrëse, për fillimin e hetimit disiplinor, vetëm për këtë 4-mujor, **ka trajtuar gjithsej 35 praktika**, ku në përfundim të shqyrtimit të tyre dhe procesit të hetimit disiplinor, ka rezultuar që;

Për **8 praktika** është përfunduar hetimi disiplinor, ku është vendosur për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

- “Përfundim nga Policia”, për 7 punonjës policie, nga të cilët:
 - 1 punonjës i nivelit të parë drejtues, me detyrë shef komisariati policie

- 1 punonjës i nivelit të parë drejtues, me detyrë shef stacioni policie
- 2 punonjës i nivelit të parë drejtues, me detyrë në strukturat e hetimit të krimit
- 1 punonjës i nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e rendit publik
- 2 punonjës i nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e kufirit dhe migracionit
- “Shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet” për 3 punonjës policie, nga të cilët:
 - 1 punonjës i nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e patrullës së përgjithshme
 - 1 punonjës i nivelit zbatues, me detyrë strukturat e kufirit dhe migracionit
 - 1 punonjës i nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e policimit në komunitet
- “Shtyrje e afatit të gradimit deri në 6 muaj” për 2 punonjës policie, nga të cilët:
 - 1 punonjës i nivelit të parë drejtues, me detyrë në strukturat e hetimit të krimit
 - 1 punonjës i nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e kufirit dhe migracionit

Për **4 praktika** është përfunduar hetimi disiplinor **pa masë disiplinore**, si më poshtë:

- për 6 punonjës policie, nuk janë konstatuar/provuar shkeljet e pretenduara.
- për 1 punonjës policie, është dhënë vendimi “Përfundim nga Policia” nga strukturat e DPPSH.

Për **3 praktika**, rekomandim për dhënie mase disiplinore për “Shkelje të lehtë”, si më poshtë:

- 2 punonjës të nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e kufirit dhe migracionit
- 1 punonjës të nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e policimit në komunitet
- 1 punonjës të nivelit zbatues, me detyrë në strukturat e qarkullimit rrugor

Për **17 praktika** është vendosur mosfillim i hetimit disiplinor, si më poshtë:

- për 2 punonjës policie, hetimi disiplinor është filluar nga strukturat e DPPSH
- për 6 punonjës policie, nuk janë konstatuar/provuar shkeljet e pretenduara
- për 8 punonjës, është dhënë vendimi nga strukturat e DPPSH për “Përfundim nga Policia”
- për 4 punonjës me status të nëpunësit civil dhe punonjës administrativë, nuk janë subjekt i veprimtarisë së Agjencisë.

Për **3 praktika** vazhdon shqyrtimi nga Komisioni Disiplinor.

Ligji ka parashikuar Komisionin e Apelimit, i cili funksionon pranë Ministrisë së Brendshme.

- Komisioni i Apelimit pranë Ministrisë së Brendshme, ka marrë në shqyrtim ankimimet e 7 punonjësve të policisë me masë disiplinore “Përfundim nga Policia”. Deri më tani ka përfunduar shqyrtimi për 3 prej tyre duke u lënë në fuqi masa e dhënë nga Komisioni Disiplinor i Agjencisë, ndërsa vazhdon hetimi për 4 punonjës të tjerë.
- Gjithashtu, Komisioni i Apelimit në MB është duke shqyrtuar dhe ankimimin e 1 prej punonjësve të policisë, për të cilin është dhënë masa disiplinore “shtyrje e afatit të gradimit deri në 6 muaj”, nga Komisioni Disiplinor i Agjencisë.

II.4. Mbikëqyrja nëpërmjet hetimit administrativ të Ankesave e Inspektimeve


Agjencia, ka siguruar kushtet e përshtatshme për marrjen, administrimin dhe trajtimin e ankesave, të cilat adresohen nëpërmjet:

- Telefonatave pranë Linjës së Gjellbër (08009090)
- Paraqitjes së qytetarëve pranë Zyrës së Ankesave
- Adresës E-mail ankesa@amp.gov.al


- *Postës zyrtare*
- *Raportimeve në aplikacionin “Komisariati Digital”*
- *Institucioneve të ndryshme*
- *Publikimeve në media*

❖ **Hetimi administrativ i Ankesave**

- Janë marrë **4686 telefonata** në linjën e gjelbër 0800 90 90
- Janë administruar **1970 ankesa**, për të cilat është kryer regjistrimi në **Sistemin e Menaxhimit të Çështjes/Moduli i Hetimit të Ankesave**.



DINAMIKA E ANKESAVE SIPAS SHËRBIMEVE




Siç shihet edhe nga grafiku i mësipërm, numri më i madh i ankesave i përket shërbimeve të policisë të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarin, siç janë strukturat e Sigurisë Publike, Policisë Rrugore apo Hetimit të Krimit, të cilët janë më të riskuar edhe në aspektin e veprimeve korruptive.

Sipas treguesve statistikorë të paraqitur në grafikun e mëposhtëm, nga sa vërehet prej trendit të shkeljeve të mundshme të kryera nga punonjësit e strukturave, të adresuara nëpërmjet denoncimeve të publikut pranë Agjencisë, rezulton se numri më i lartë i ankesave është për vendosjen e masave administrative dhe veprime arbitrare (këtu përfshihen shqërimet të padrejta, dhunë fizike ose psikologjike, shkelje të normave të etikës, etj).

Krahasuar me vitin 2021, ky trend rezulton të jetë pothuajse në të njëjtat vlera, por vërehet një rritje e denoncimeve/ankesave në drejtim të krimit mjedisor (zhurma/ ndërtime të paligjshme/prerje të drurëve, etj).

Të ndara sipas tendencës së shkeljeve të raportuara, gjendja paraqitet si vijon:




a) Përfundimi i hetimeve:

- Në **44** raste është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor për **58** punonjës policie, nga të cilët **1** punonjës i nivelit të mesëm drejtues, **14** punonjës të nivelit të parë drejtues, **42** punonjës të nivelit zbatues, **1** punonjës administrativ. Sipas strukturave ata ndahen si më poshtë vijon:
 - **19** punonjës të strukturave të patrullës së përgjithshme,
 - **10** punonjës të strukturave të policimit në komunitet,
 - **10** punonjës të strukturave të qarkullimit rrugor,
 - **6** punonjës të strukturave të kufirit dhe migracionit,
 - **5** punonjës të strukturave të posaçme,
 - **4** punonjës të strukturave të hetimit të krimit
 - **3** punonjës/anëtarë të OASH-së,
 - **1** punonjës i strukturave të hetimit të krimit ekonomiko-financiar

❖ Hetimi administrativ nëpërmjet inspektimeve


Agjencia ka programuar dhe realizuar veprimtarinë inspektuese si pjesë e gjithë konfiguracionit të mbikëqyrjes dhe monitorimit, e cila siguron përmbushjen e detyrave institucionale dhe parandalimin e veprimtarisë së kundërligjshme të kryera nga subjekte, si dhe përcaktimin e përgjegjësisë administrative apo penale për subjektet përgjegjëse. Janë zhvilluar **117 inspektime**, prej të cilave:



Në përfundim të veprimtarisë inspektuese, për mangësitë e konstatuara;

- Janë dhënë **152 rekomandime** për përmirësimin e punës së këtyre strukturave.
- Janë referuar materialet procedurale në Prokurori në **6 raste për 9 punonjës** policie, nga të cilët; **5 punonjës** të nivelit të parë drejtues dhe **4 punonjës** të nivelit zbatues,
- Është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor në **20 raste për 77 punonjës** policie, nga të cilët **5 punonjës** të nivelit të mesëm drejtues, **37 punonjës** të nivelit të parë drejtues, **33 punonjës** policie të nivelit zbatues dhe **2 punonjës** administrativë.

Referuar shërbimeve, nga **117 inspektimet** e kryera rezulton se:




Të dhëna krahasuese sipas viteve:

Periudha	Numri i inspektimeve		Struktura	Rekomandime	H. Disiplinore	Referime
	Planifikuara	Paplanifikuara				
Viti 2019	10	63	70	181	265 punonjës	20 punonjës
Viti 2020	29	59	62	282	83 punonjës	2 punonjës
Viti 2021	43	67	72	439	288 punonjës	2 punonjës
Viti 2022	16	101	117	152	77 punonjës	9 punonjës

II.5. Mbikëqyrja nëpërmjet veprimtarisë së hetimit procedural penal

Hetimi procedural penal mbetet një nga shtyllat kyçe të veprimtarisë së Agjencisë, i cili është edhe procesi që finalizon produktet pozitive të veprimtarive të tjera. Në këtë kontekst, hetimi procedural penal ka arritur nivele të kënaqshme në të gjitha komponentët; sasi, cilësi dhe në evidentimin e veprave penale të përcaktuara në Programin Vjetor si prioritare dhe fenomene shqetësuese. Treguesit e veprimtarisë procedurale penale reflektohen në të dhënat e mëposhtme:



Hetimet proaktive në ndjekje nga strukturat tona të hetimit në nivel vendor e qendror zënë rreth **33% të totalit të referimeve** të kryera gjatë këtij viti.

Strukturat e Hetimit të Agjencisë në nivel vendor apo qendror, në interes të dokumentimit të ngjarjeve që kanë ndodhur në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, MNZSH-në, etj, kanë realizuar dhe veprime me iniciativë, ku kanë kryer arrestime/ndalime në flagrancë për **42 punonjës**

të strukturave dhe **19 shtetas**. Është për t'u theksuar se nga këto veprime, në asnjë rast nuk është evidentuar paligjshmëri gjatë vlerësimeve të masave të sigurimit nga prokuroria dhe gjykatat. Sa i përket hetimeve në ndjekje me SPAK apo Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, sipas vendimeve Penale të Gjykatave, janë ekzekutuar masat e sigurisë si më poshtë vijon:

Masa e sigurimit personal "**Arrest në burg**" caktuar për **39 persona**, nga të cilët

- 7 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
- 19 punonjës policie të nivelit zbatues
- 6 punonjës administrativë (civilë)
- 7 shtetas

Masa e sigurimit personal "**Arrest në shtëpi**" caktuar për **26 persona**, nga të cilët

- 1 punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues
- 2 punonjës policie i nivelit të parë drejtues
- 15 punonjës policie të nivelit zbatues
- 5 punonjës administrativë (civilë)
- 3 shtetas


Masa e sigurimit personal "**Pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik**" caktuar për **38 persona**, nga të cilët

- 1 punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues
- 5 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
- 30 punonjës policie të nivelit zbatues
- 2 punonjës dogane (shtetas)

Masa e sigurimit personal "**Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore**" caktuar për **7 persona**, nga të cilët

- 5 punonjës policie të nivelit zbatues
- 1 efektiv i Gardës së Republikës
- 1 shtetas

Të shprehura në %, rastet e implikimit në format e paligjshmërisë të sipërcituara, i paraqesim sipas grafikut si vijon:




Ky grafik reflekton pothuajse të njëjtën tendencë të formave dhe fenomeneve të paligjshmërisë të evidentuar ndër rradhët e strukturave si në vitet e mëparshme, ku përqindjen më të lartë me **29 % të totalit të referimeve** e zënë rastet e përfshirjes në *“korrupsion dhe shpërdorim detyrë”*, pasuar me **17% të totalit** rastet e kryerjes së veprave penale *“kundër personit me dashje dhe nga pakujdesia, si dhe kundër familjes”* (kanosje, plagosje, vrasje, dhunë në familje etj); për të vijuar me **11 % të totalit të referimeve** me rastet e *“kryerjes së veprimeve arbitrare”* dhe **9% të totalit të referimeve** për rastet e kryerjes së veprave penale të *“vjedhjes dhe vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”*.

Për t’u evidentuar edhe për këtë vit, në % të konsiderueshme, rreth **9 % të totalit**, janë rastet e shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor nga vetë punonjësit e policisë, me pasoja materiale apo edhe në njerëz, në kushtet kur pjesa dërmuese e punonjësve ka qenë nën efektin e pijeve alkoolike shumë herë mbi kufirin e lejuar.

❖ Tregues krahasimor për vitet 2019, 2020, 2021, 2022


TREGUES KRAHASIMOR NR. REFERIMEVE



TREGUES KRAHASIMOR NR. SUBJEKTEVE TË REFERUAR



Nr. subjekteve të arrestuar/ndaluar/masë sigurie



❖ Operacionet/hetimet penale të suksesshme

Nga strukturat e hetimit të Agjencisë në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë/Prokurorisë së Posaçme (SPAK) janë kryer **10 operacione** për zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e paligjshmërisë së punonjësve të policisë në format e “Korrupsionit pasiv”, “Shpërdorimit të detyrës”, Favorizimit të “kultivimit të bimëve narkotike” e “Kontrabandës”, dhe tendencave të tjera, ku do të veçojmë:

Finalizimi i operacionit “PIKA 2” i kryer në bashkëpunim ndërmjet Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP), Departamentit të Policisë Kufitare e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në koordinim me Prokurorinë Speciale dhe Inspektoratin Policor (IPK) të Republikës së Kosovës.

Pas një hetimi objektiv dhe të gjithëanshëm, me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme u caktuan nga **Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 34 masa sigurimi personal, nga të cilat 32 punonjës të Policisë Kufitare Kukës**, me funksione të ndryshme brenda Drejtorisë të Kufirit dhe Migracionit Kukës, duke përfshirë edhe **Drejtorin e kësaj Drejtorie**, për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 248, 259, 25 dhe 245/1 të Kodit Penal. Masat e sigurimit personal janë:

- “Arrest në burg” për **16 punonjës policie**
- “Arrest në shtëpi”, për **12 punonjës policie dhe 2 shtetas**
- “Pezullim nga detyra”, për **4 punonjës policie**.

Me vendimin nr. 13, datë 16.05.2022, Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar lë në fuqi masat e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë për të gjithë punonjësit e policisë.

II.6. Mbikëqyrja nëpërmjet CSP

Agjencia, në cilësinë e një prej tre Autoriteteve Verifikuese në vend, sipas përcaktimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e Rregullave për Sigurimin e Personelit” ka organizuar dhe ndjekur punën për procesin e verifikimit të kushtit të sigurisë në kuadër të:

- aplikimit të personave për Certifikatë të Sigurimit të Personelit,
- procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve/prokurorëve sipas ligjit 84/2016,
- procesit të rivlerësimit të strukturave sipas ligjit 12/2018, i ndryshuar,
- procesit të verifikimit të kandidatëve për strukturat e reja të drejtësisë, sipas ligjit 96/2016.

Këto procedura verifikuese janë kryer në bashkëpunimin me Sektorin e Analizës & Informacionit, Sektorin e Kartotekës së Agjencisë, Kartotekën e Policisë Kriminale, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Autoritetet Verifikuese në vend, duke trajtuar **7170 praktika për 4491 persona dhe 1223 punonjës të strukturave**, objekt i veprimtarisë së Agjencisë.

Në përfundim të procedurave verifikuese nga ana e Shërbimit, për punonjësit e strukturave, objekt i veprimtarisë së Shërbimit, janë adresuar pranë DSIK me vlerësimin “që përbëjnë rrezik për pajisjen me CSP, të subjekteve të Shërbimit”, në kuadër të aksesit dhe njohjes me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror” për:

- Vitin 2020 – 115 subjekte, subjekte të Agjencisë,
- Vitin 2021 – 61 punonjës, subjekte të Agjencisë,
- Vitin 2022 – 39 punonjës, subjekte të Agjencisë,

Nga ana e DSIK jemi njoftuar për refuzimin/pezullimin për pajisje me CSP, për:

- Vitin 2020 – 75 punonjës, subjekte të Agjencisë,
- Vitin 2021 – 57 punonjës, subjekte të Agjencisë
- Vitin 2022 – 47 punonjës, subjekte të Agjencisë.

II.7. Integriteti/Vetingu i punonjësve të Agjencisë dhe të strukturave mbikëqyrëse

- Duke qenë se personeli i Agjencisë është subjekt i ligjit nr.12/2018, gjatë vitit 2022 ka filluar prej Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (KJV) procesi i vlerësimit kalimtar për 42 punonjës të Agjencisë, anëtarë të trupave vlerësuese, ku nga momenti i shortimit dhe deri në fund të vitit 2022, kemi 28 vendime, nga të cilët:
 - Për 21 punonjës është vendosur “konfirmim në detyrë”,
 - Për 2 punonjës është vendosur “ndjekje e trajnimit profesional”,
 - Për 4 punonjës është vendosur “ndërprerje e procesit të vlerësimit”,
 - Për 1 punonjës është vendosur “përrjashtim nga detyra”.
- Në cilësinë e Autoritetit Vlerësues, që Agjencia gëzon nga ligji 12/2018 i ndryshuar, por dhe ligji organik i saj nr. 128/2021, gjatë këtij viti është fokusuar vëmendja në bashkëpunim dhe me strukturat përkatëse të Ministrisë së Brendshme, duke synuar rregullimin e disa procedurave dhe standardeve që lidhen me:
 - a. reduktimin dhe kufizimin e subjekteve të përcaktuara në ligjin 12/2018 dhe kryerjen e procesit të vlerësimit nëpërmjet një strukture permanente vlerësimi për zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s;
 - b. përcaktimin e një afati ligjor për kryerjen e procesit të vlerësimit;
 - c. futjen në rol të institucioneve të tjera ndihmëse në proces, si ILDKPKI;
 - d. plotësimin e vakumeve ligjore;
 - e. standardizimin dhe detajimin e procedurave të vlerësimit për të tre komponentët: pasuri, figurë dhe profesionalizëm;
 - f. parashikimin e sanksioneve ligjore për t'i dhënë fuqi detyruese zbatimit të vendimit të trupave të vlerësimit nga institucionet përkatëse;
 - g. parashikimin e procedurave të dorëzimit dhe arkivimit të dosjeve të shorteve të papërfunduara nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit.

Grupi i punës së ngritur me Urdhër të Ministrit të Brendshëm draftoi projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr. 12/2018 “Për Vetingun”, i cili iu nënshtrua mendimeve dhe sugjerimeve të institucioneve të linjës, konsultimit publik dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces.

Këto ndryshime dhe shtesa janë miratuar me ligjin nr. 78/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme”, i ndryshuar””, i cili ka hyrë tashmë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare, nr. 165, datë 13.12.2022.

- Në kuadër të projektit risi për vendin tonë, ai i “Testimit Poligrafik”, Struktura Poligrafike e certifikuar e Agjencisë, në zbatim të një marrëveshje të nënshkruar ndërmjet institucionit tonë dhe agjencive ligjzbatuese dhe inteligjente nw vend, ka kryer ekzaminimin poligrafik të **121 punonjësve**, në funksion të procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës dhe kushtit të sigurisë.

II.8. Menaxhimi i shërbimeve mbështetëse

❖ Për menaxhimin e shërbimeve logjistike

- Hartimi i disa dokumenteve të rëndësishme në fushën e menaxhimit të shërbimeve logjistike si:
 - PBA-a 2023 – 2025 dhe përgatitja e fish-projekteve për investimet,
 - Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve, krijimi në faqen e APP-së dhe ndjekja e realizimit të tij,
 - Procedurat Standarde dhe Përshkrimet e Punës për shërbimet logjistike,
 - Aktet administrative për menaxhimin dhe përdorimin e mjeteve të transportit në përdorim të Agjencisë,
- Kryerja e 29 procedurave të prokurimit, nga të cilat 1 me praktikë sekrete, 2 me procedurë të hapur, 26 procedura blerje të vogla nëpërmjet sistemit të APP-së. Gjatë gjithë procesit të prokurimeve nuk ka patur asnjë ankimim nga operatorët ekonomikë. Disa nga projektet kryesore realizuar me fonde buxhetore janë:
 - “Mobilimi i Drejtorive Rajonale”,
 - “Blerje pajisje sigurie për rrjetet e Agjencisë dhe ndarja e Arkivës Dixhitale më vete”,
 - “Blerje pajisje kondicionimi për nevoja operationale”.

❖ Për menaxhimin e burimeve njerëzore

- **Largim, përjashtim, lirim nga puna**
 - Janë larguar nga detyra **25 punonjës** me motivacione të ndryshme, ku:
 - **18** punonjës me motivacionin “Me kërkesën e tij”
 - **3** punonjës janë “Përjashtuar nga Agjencia” me vendim të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.
 - **1** punonjës është “Liruar nga detyra”, pasi i është hequr “CSP”;
 - **2** punonjës kanë “ndërruar jetë”.
 - **1** punonjës ka dalë në pension pleqërie.
- **Masat Disiplinore**

Janë hetuar dhe verifikuar gjithsej **15 punonjës** të Agjencisë, të cilët janë ndëshkuar me:

 - **12 punonjës** me masë disiplinore “Vërejtje”
 - **1 punonjës** me masë disiplinore “Përjashtim nga Shërbimi”
 - **1 punonjës** me masë disiplinore “Shtyrje e afatit të gradimit deri në 12 muaj”
 - **1 punonjës** me masë disiplinore “Gjobë në masën sa paga e punonjësit për 10 ditë pune”

❖ Për rrjetet dhe sistemet e TI-së

- Realizimi i Projektit për ndarjen e Arkivës Dixhitale në një infrastrukturë të veçantë,
- Realizimi i projektit për ndërtimin e Ndërfaqes së AMP-së,
- Ndjekja e projektit për implementimin e sistemit të analizimit të të dhënave “iBase”,
- Mirëmbajtja e sistemit të databazës së thirrjeve telefonike të linjës së gjelbër 08009090,
- Realizimi i inspektimit në bashkëpunim me DSIK dhe Drejtorinë e Shifrës me objekt “Akreditimin e sigurisë së sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit që operojnë në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.

❖ Performanca financiare

Për vitin 2022, Agjencisë i janë akorduar fonde buxhetore në shumën prej 228,399,000 lekë (duke përfshirë ndryshimet gjatë vitit). Ky fond është realizuar në shumën prej 224,211,611 lekë, ose në masën 98%.

Më poshtë paraqesim pasqyrën përmblledhëse të realizimit të shpenzimeve buxhetore të artikujve kryesorë të strukturës buxhetore;

(në lekë)

Nr.	Art.	Emërtimi	Plani	Realizimi	Diferenca	Realizimi në %
1	600	Paga & shpenzime personeli	140,194,000	140,168,881	25,119	100%
2	601	Sigurime shoqërore	24,501,000	23,357,952	1,143,048	95%
3	602	Mallra e shërbime	46,150,000	43,470,380	2,679,620	94%
4	606	Transf.buxhetet familjare	3,794,000	3,793,638	362	100%
5	230	Shpenzime për rritjen e aktiveve të patrupëzuara	1,159,000	1,159,000	0	100%
6	231	Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara	12,601,000	12,261,760	339,240	97%
TOTALI			228,399,000	224,211,611	4,187,389	98%

II.9. Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë/trajnimi i vazhdueshëm i personelit

Në kuadër të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të brendshme të Agjencisë, nëpërmjet bashkëpunimit me organizma të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit janë zhvilluar:

- Në periudhën Mars – Qershor 2022, **10 punonjës** të Agjencisë morën pjesën në trajnimin e zhvilluar në Akademinë ILEA, Budapest, Hungari. Tematika e këtij trajnimi është e fokusuar në çështje që lidhen me “*Luftën kundër korrupsionit publik*”. Trajnimi është financuar nga ICITAP.
- Në periudhën 13 – 15 Qershor 2022 dhe 1 – 2 Shtator, **2 punonjës** të Agjencisë morën pjesë në trajnimin e zhvilluar në Vilnius, Lituani, me temë “*Analizimi i të dhënave të mëdha (Big data) për të parandaluar e zbuluar korrupsionin dhe mashtrimin që prekin interesat financiare të BE-së*”.

- Në datat 29 – 30 Shtator 2022, **1 punonjës** i Agjencisë, njëkohësisht dhe personi i kontaktit/anëtari i grupit të punës pranë MD, mori pjesë në trajnimin me tematikë “*Organizimi, menaxhimi dhe koordinimi i punës me grupet e interesit (stakeholders)*”, i organizuar nga Drejtoria e Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion me një bashkëpunim me Projektin e Asistencës Teknike për Antikorrupsionin, të Delegacionit të Bashkimit Evropian.

II.10. Bashkëpunimi ndërinstytucional brenda dhe jashtë vendit

Agjencia ndër vite dhe në mënyrë të vazhdueshme është mbështetur nga programet dhe misionet e huaja brenda dhe jashtë vendit në rrugën e saj drejt konsolidimit si një Agjenci e Mbikëqyrjes së Jashtme Policore, si dhe reformave të vazhdueshme institucionale dhe përshtatshmërive ligjore, organizative e funksionale. Mbështetja e dhënë ka qenë e fokusuar në asistencën ligjore për ligjin e ri organik të Agjencisë, trajnime për personelin e saj, si dhe donacione për pajisje e sisteme kompjuterike.

Agjencia ka bashkëpunuar dhe vazhdon të ketë një bashkëpunim të ngushtë me misionet, programet apo edhe agjencitë tona homologe si; OSBE, PAMECA, CIDS, ILEA, EPAC, IPK, ICITAP, etj.

Është për t'u vlerësuar bashkëpunimi dhe ndihma e dhënë nga ICITAP, në draftimin e ligjit të ri të Agjencisë, trajnimeve të vazhdueshme për personelin e ri të Agjencisë sonë dhe të personelit ekzistues dhe në veçanti për donacionin për ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Çështjes me modulet e saj, atë të Hetimit Administrativ të Ankesave dhe Hetimit Procedural Penal.

EPAC (Partnerët European Kundër Korrupsionit), rrjeti që bën bashkë 70 Autoritete antikorrupsion dhe organizma të mbikëqyrjes policore nga vendet anëtare të Këshillit të Europës me qëllimin e vetëm, parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Agjencia, anëtare me të drejta të plota në këtë rrjet, prej vitit 2010 është angazhuar në shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira për hartimin e Manualeve Standarde të Punës për të dy kategoritë e institucioneve, si Agjencitë Antikorrupsion, ashtu edhe Agjencitë e Mbikëqyrjes Policore, Buletineve Periodike mbi aktivitetet apo risitë e reja ndër vendet anëtare si në aspektet ligjore, organizative e funksionale.

IPK (Inspektorati Policor i Kosovës) në bazë dhe të Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Mirëkuptimit ndërmjet dy institucioneve tona, bashkëpunimi ynë është shtrirë në të gjitha drejtimet, nga shkëmbimi i eksperiencave më të mira në fushat respektive të veprimtarisë, në zhvillimin e inspektimeve tematike dhe sidomos në hetime penale të suksesshme, siç ishte Operacioni “PIKA 2”, i kryer në bashkëpunim ndërmjet Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP), Departamentit të Policisë Kufitare e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në koordinim me Prokurorinë Speciale dhe Inspektoratin Policor (IPK) të Republikës së Kosovës.

II.11. Proceset integruese të Shqipërisë në BE/përmbushja e detyrimeve nga Strategjitë Ndërinstytucionale dhe Planet Konkrete të Veprimit

Agjencia është pjesë e grupeve ndërinstytucionale të punës për çështje që lidhen me Proceset Integruese të vendit tonë në BE, për fushën e përgjegjësisë ligjore dhe institucionale. Gjithashtu,

AMP është e angazhuar në grupet ndërinstitucionale të punës për ndjekjen e Strategjive dhe Planeve konkrete të Veprimit, ku gjatë këtij viti ka raportuar për:

- Takimin Bashkimi European – Shqipëri, Komiteti i 12-të i Stabilizim – Asociimit;
- Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015 – 2023 e Planit të Veprimit;
- Raportin Vjetor Shtetëror për Luftën Kundër Korrupsionit 2021;
- Për Hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021 – 2030;
- Raport Progresit të Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2022;
- Planit të veprimit për realizimin e prioriteteve të MB - 300 ditët/2022;
- Hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023 – 2030;
- Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave 2021 – 2023;
- Takimit dypalësh BE-Shqipëri, për kapitullin 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”.
- Takimit dypalësh BE-Shqipëri, për kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.

Agjencia përfaqësohet në grupet ndërinstitucionale të punës si:

- Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNPIE) për kapitullin “Kriteri Politik” dhe “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, me lider Ministrinë e Drejtësisë.
- Grupi Ndërinstitucional i Punës në DSIK, për “Kontrollin e Figurës”, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

III. SFIDAT/PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023

Në përmbushje të prioriteteve dhe objektivave përkatëse të parashikuar në “Strategjinë për Zhvillimin e Agjencisë 2020 – 2024”, nëpërmjet të cilave do të arrihet konsolidimi organizativ dhe funksional i Agjencisë, gjatë vitit 2023, veprimtaria e strukturave tona do të fokusohet kryesisht në këto drejtime:

- ❖ **Vijimi i konsolidimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore**, nëpërmjet përfundimit të hartimit dhe miratimit të paketës së akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 128/2021 për Agjencinë, si; Vendime të Këshillit të Ministrave, Udhëzime të Ministrisë të Brendshme dhe akteve normative në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm.
- ❖ **Implementimi i strukturës dhe përbërjes së re organike të Agjencisë**, e riorganizuar në funksion të përgjegjësiave dhe kompetencave të reja ligjore dhe institucionale.
 - Riemërimi në detyrë i personelit aktual të Agjencisë,
 - Shpallja e fituesve dhe emërimi në detyrë i personelit të ri,
 - Trajnim bazë në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë dhe institucione të tjera ligjzbatuese dhe inteligjente në vend.
- ❖ **Vazhdimi i Implementimit të “Strategjisë për Zhvillimin e Agjencisë 2020 – 2024”**
 - Analiza e realizimit dhe mosrealizimit të objektivave, masa konkrete të Planit të Veprimit 2020 – 2022.
 - Hartimi dhe miratimi i Planit të ri të Veprimit 2023 – 2024 në kuadër të Strategjisë për Zhvillimin e Agjencisë”.
 - Implementimi dhe zbatimi i masave dhe detyrave të parashikuara në Planin e ri të Veprimit.

- ❖ **Fillimi i procesit të Vetingut** – pas miratimit të ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 12/2018, me ligjin nr. 78/2022, datë 17.11.2022
 - *Rishikimi i akteve nënligjore të Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm që normojnë këtë veprimtari, në përputhje me ligjin e ri që do të miratohet,*
 - *Marrja në dorëzim e gjithë dosjeve të administruara nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit,*
 - *Fillimi i procesit të vlerësimit sipas përcaktimeve, kategorive dhe mënyrës së përcaktuar në ligjin e ri.*
- ❖ **Hetimi disiplinor** i punonjësve të strukturave mbikëqyrëse, për shkeljet e rënda të konstatuara gjatë veprimtarive të Agjencisë.
 - *Zhvillimi i hetimit disiplinor për rastet e konstatuara.*
- ❖ **Hetimi administrativ i ankesave dhe inspektimeve**
 - *Përmirësimi i sistemit të Menaxhimit të Ankesave me modulën e inspektimit dhe paralajmërimit të hershëm.*
 - *Zhvillimi i inspektimeve mbi bazë analize risku dhe kryesisht në ato struktura me risk më të lartë korrupsioni apo implikimin në formë të tjera paligjshmërie;*
- ❖ **Hetimi procedural penal & analiza e informacionit kriminal**
 - *Implementimi i rregullave, normave dhe procedurave të reja të parashikuara në aktin nënligjor të Ministrit të Brendshëm në aplikimin e procesit informativ, në funksion të veprimtarisë parandaluese,*
 - *Vënia në efikasitet të bazës së të dhënave të Agjencisë nga strukturat e hetimit në nivel qendror dhe vendor,*
 - *Draftimi dhe miratimi i manualeve dhe procedurave standarde të punës për përdorimin e kësaj baze të dhënash,*
 - *Trajnimi i personelit për përdorimin e tij,*
 - *Ndjekja me prioritet të hetimeve proaktive që ndiqen me Prokurorinë e Posaçme (SPAK), por dhe prokuroritë e tjera.*
- ❖ **CSP – kushti i sigurisë dhe pastërtia e figurës** për personelin e subjekteve mbikëqyrëse dhe jo vetëm;
 - *Implementimi i normave, procedurave dhe rregullave të parashikuara në aktet nënligjore të Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm që rregullojnë këtë veprimtari të AMP-së, në përputhje me ligjin e ri organik,*
 - *Ndjekja dhe kryerja e procedurave aplikuese dhe verifikuese për kushtin e sigurisë për personelin e strukturave mbikëqyrëse.*
- ❖ **Proceset Integruese të Shqipërisë në Bashkimin Evropian/bashkëpunimi ndër-institucional**
 - *Përmbushja e detyrimeve të Agjencisë që rrjedhin nga Strategjia Ndërsektoriale dhe Planë Konkrete të Veprimit.*
 - *Angazhimi i vazhdueshëm në Grupet Ndër-institucionale të Punës për ndjekjen dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga rekomandimet e lëna nga Bashkimi Evropian për institucionet shqiptare, në kuadër të aderimit të Shqipërisë në BE.*